- Detajon fondet buxhetore të miratuara me ligj për Institucionin dhe harton përmbledhësen vjetore të detajimit të shpenzimeve korrente e kapitale;
- Përgatit parashikimin limit mujor të shpenzimeve për Institucionin;
- Shqyrton kërkesat për rialokimin dhe shtesat e fondeve buxhetore nga njësitë organizative dhe kryen procedurat, sipas udhëzimit të zbatimit të buxhetit, për transferimin e fondeve për Institucionin;
- Harton dhe ndjek në dy fazat e kostimit të planit buxhetor afatmesëm për Programin “Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike”. Regjistron deklaratën, objektivat e politikës, produkteve dhe aktivitetet e vetë planifikuara në programin për PBA-në si dhe kostimi i produkteve dhe monitorimi i tyre, për këtë program;
- Harton relacione për argumentimin e kërkesave në kuadër të instrumentit të PBA dhe rastet e ndryshimeve ndërmjet zërave të programit, rialokimet apo shtesat për fonde buxhetore përgjatë vitit financiar;
- Harton shkresa për kontaktet dhe korrespondencën zyrtare, në kuadër të funksioneve të buxhetimit vjetor dhe afatmesëm, me ministrinë përgjegjëse për financat dhe Kryeministrinë, si organ epror;
- Bën regjistrimet e aktivitetit çdo muaj në librat e kontabilitetit si: ditarët e bankës, ditarin e arkës, ditarin e pagave etj;
- Llogarit, evidenton dhe ekzekuton në kohë pagat, sigurimet shoqërore, udhëtimet e dietat, shpenzime të tjera, që i përkasin personelit të ADISA-s. Hedh të dhënat e pagave/sigurimeve në librin e pagave;
- Zbaton dhe ndjek politikat e pagave, sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi;
- Përgatit urdhër-shpenzimet për likuidimin e faturave të furnizimit të shërbimeve/mallrave nga të tretët, si dhe të detyrimeve kontraktuale që ka ADISA;
- Kryen rakordime periodike financiare me Degën e Thesarit Tiranë në kuadër të zbatimit të planit të buxhetit;
- Azhornon dokumentacionin e magazinës, siguron në çdo muaj rakordimin e gjendjes kontabël të mallrave e materialeve të magazinës me inventarin fizik;
- Kryen veprimet e arkës dhe shpenzimet në valutë për shërbimet jashtë vendit;
- Plotëson librin e pagave dhe librezat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve;
- Punon periodikisht, në mënyrë të pavarur, për ngritjen profesionale dhe përditësimin me ndryshimet e legjislacionit;
- Monitoron Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik dhe raporton dy herë në ditë, në orën 9:30 dhe në orën 16:00 tek koordinatori përgjegjës i Bashkëqeverisjes mbi mbarëvajtjen e aplikimeve, të cilat i janë caktuar sipas institucionit që monitoron, bazuar në raportin model të përcaktuar nga ADB-ja;

- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të përpiluar në mënyrë ditore, raportin e monitorimit të aplikimeve dhe përcaktimin e personave përgjegjës të cilët nuk kanë përmbushur afatet;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të identifikuar problematikat me aplikimet e prapambetura;
- Sigurohet që përcjellja e rastit kryhet brenda 24 orësh nga ardhja në platformë;
- Sistemon e-maillet në rastet kur janë gabim dhe kontakton qytetarët në rastet kur ankesa nuk ka e-mail të saktë;
- Nëpërmjet platformës dërgon kujtesa tek institucionet, kur rasti u afrohet afateve të kthimit të përgjigjes;
- Raporton në mënyrë javore dhe sipas kërkesës tek koordinatori përgjegjës i ADB-së mbi ecurinë e rasteve që ndjek;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (*me shkrim dhe verbal*) të eprorëve.

B. Kriteret e punësimit të Specialistit janë:

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe të zotërojë të zotërojë të paktën diplomën Bachelor në shkencë ekonomike;
- Njohuri nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuri mbi ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 13/2016 datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;
- Njohuri mbi Vendimin Nr. 252, datë 29.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”;
- Njohuri mbi Urdhërin nr. 87, datë 13.05.2022 “Për angazhimin e strukturave të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për të bashkëpunuar me Agjencinë për

Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), për realizimin e disa detyrave lidhur me ofrimin e shërbimeve”;

- Njohuri mbi Urdhërin e Përbashkët nr. 428/1 Prot., datë 01.07.2022 “Mbi mënyrën e rregullimit të procesit të bashkëpunimit midis ADISA-s dhe ADB-së”;
- Njohuri mbi aktet në fuqi në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e financave publike;
- Njohuri mbi Strategjitë dhe Prioritetet e programit të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë ndikim direkt në rolin publik të Institucionit;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike;
- Të njohë një nga gjuhët e BE (avantazh përbën gjuha angleze);
- Do të ketë prioritet në vlerësimin e kandidaturave personat që kanë mbi 1 (një) vit eksperiencë pune në pozicione të ngjashme/ekuivalente.

8.3 Sektori i Investimeve

Sektori i Investimeve në kuadër të shtrirjes së ADISA-s në territor, ka si funksion ndjekjen dhe monitorimin e të gjithë fazave të kryerjes së investimeve në sportelet e ADISA-s, Qendrat e Integruara apo në çdolloj forme tjetër të organizimit të tyre.

8.3.1 A. Detyrat e Përgjegjësit janë:

- Përgjigjet para drejtorit përkatës dhe kur i kërkohet drejtpërdrejt para Drejtorit Ekzekutiv, për shkallën e plotësimit të detyrave të ngarkuara nga ana e tij dhe punonjësve të sektorit;
- Merr masa organizative për plotësimin e detyrave nga çdo punonjës në veçanti dhe si sektor brenda planifikimit të detyrave të drejtorisë;
- Evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditshme, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon drejtorit rrugë zgjidhjet përkatëse;
- Kontrollon punën e përditshme të specialistëve në varësi, për plotësimin e detyrave që u janë ngarkuar;
- Organizon punën për realizimin e projekt-ideve të kërkuara, projekteve të zbatimit (paraprake) dhe të punimeve në përputhje me formimin profesional, në kohën e duhur me cilësinë e kërkuar dhe duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe ekonomik;
- Monitoron dhe ndjek nga afër dhe në detaje kryerjen e punimeve në terren nga firmat sipërmarrëse, në kuadër të kontratave të Mbikëqyrjes;
- Përgatit informacione për eprorin e drejtpërdrejtë dhe Drejtorin Ekzekutiv, mbi ecurinë e procedurave dhe të punimeve në këto kontrata dhe problemet që dalin gjatë zbatimit të tyre;
- Evidenton problemet që dalin gjatë zbatimit të punimeve, përgatit relacione dhe dokumente të nevojshme për institucionet që do të marrin pjesë për zgjidhjen e tyre;
- Analizon dhe ndjek zbatimin e programeve të investimeve në zhvillimin e infrastrukturës në kuadër të planit të shtrirjes së agjencisë në territor;

- Përgatit akte të përgjithshme të planifikimit të investimeve, realizon procedurat për hartimin e programit të investimeve publike në kuadër të PBA-së, bashkëpunon me institucionet në rastin e përgatitjes së termave të referencës dhe hartimit të projekteve;
- Punon periodikisht, në mënyrë të pavarur, për ngritjen profesionale dhe përditësimin me ndryshimet e legjislacionit;
- Kontrollon, analizon dhe informon mbi rezultatet e punës së punonjësve në varësi të tij;
- Vlerëson performancën e punonjësve në varësi në përputhje me procedurat e aplikueshme;
- Monitoron Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik dhe raporton dy herë në ditë, në orën 9:30 dhe në orën 16:00 tek koordinatori përgjegjës i Bashkëqeverisjes mbi mbarëvajtjen e aplikimeve, të cilat i janë caktuar sipas institucionit që monitoron, bazuar në raportin model të përcaktuar nga ADB-ja;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të përpiluar në mënyrë ditore, raportin e monitorimit të aplikimeve dhe përcaktimin e personave përgjegjës të cilët nuk kanë përmbushur afatet;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të identifikuar problematikat me aplikimet e prapambetura;
- Sigurohet që përcjellja e rastit kryhet brenda 24 orësh nga ardhja në platformë;
- Sistemon e-maillet në rastet kur janë gabim dhe kontakton qytetarët në rastet kur ankesa nuk ka e-mail të saktë;
- Nëpërmjet platformës dërgon kujtesa tek institucionet, kur rasti u afrohet afateve të kthimit të përgjigjes;
- Raporton në mënyrë javore dhe sipas kërkesës tek koordinatori përgjegjës i ADB-së mbi ecurinë e rasteve që ndjek;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (*me shkrim dhe verbal*) të eprorëve.

B. Kriteret e punësimit të Përgjegjësit janë:

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe të zotërojë diplomë Master Shkencor në shkencë inxhinierike/ekonomike/juridike/shoqërore;
- Njohuri nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 13/2016 datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;

- Njohuri mbi Vendimin Nr. 252, datë 29.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”;
- Njohuri mbi Urdhërin nr. 87, datë 13.05.2022 “Për angazhimin e strukturave të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për të bashkëpunuar me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), për realizimin e disa detyrave lidhur me ofrimin e shërbimeve”;
- Njohuri mbi Urdhërin e Përbashkët nr. 428/1 Prot., datë 01.07.2022 “Mbi mënyrën e rregullimit të procesit të bashkëpunimit midis ADISA-s dhe ADB-së”;
- Njohuri mbi Strategjitë dhe Prioritetet e programit të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë ndikim direkt në rolin publik të Institucionit;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike;
- Të njohë një nga gjuhët e BE (avantazh përbën gjuha angleze);
- Të ketë të paktën 2 (dy) vjet eksperiencë pune në pozicione të ngjashme/ekuivalente.

8.3.2 A. Detyrat Specialistit janë:

- Asiston në realizimin e projekt-ideve të kërkuara, projekteve të zbatimit (paraprake) dhe të punimeve në kohën e duhur me cilësinë e kërkuar dhe duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm teknik dhe ekonomik;
- Ndjek dhe asiston zbatimin e programeve të investimeve në zhvillimin e infrastrukturës në kuadër të planit të shtrirjes së ADISA-s në territor;
- Asiston dhe evidenton problemet që dalin gjatë zbatimit të punimeve;
- Përgatit dhe përditëson relacione dhe dokumente të nevojshme për institucionet që do të marrin pjesë për zgjidhjen e tyre, asiston në kryerjen e analizimit të nevojave reale për rikonstruksione apo investime të reja të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit të ofrimit të shërbimeve publike në të gjitha qendrat e Integruara ADISA;
- Punon për rritjen dhe kualifikimin e tij profesional në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, duke synuar sjelljen e risive në punën e tyre të përditshme;
- Zbaton detyrat e ngarkuara sipas rregulloreve në fuqi si dhe planeve të punës të miratuara nga drejtori përkatës;
- Informon eprorin direkt mbi rezultatet e punëve në vazhdimësi dhe mbi vështirësitë e hasura në lidhje me to;
- Monitoron Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik dhe raporton dy herë në ditë, në orën 9:30 dhe në orën 16:00 tek koordinatori përgjegjës i Bashkëqeverisjes mbi mbarëvajtjen e aplikimeve, të cilat i janë caktuar sipas institucionit që monitoron, bazuar në raportin model të përcaktuar nga ADB-ja;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të përpiluar në mënyrë ditore, raportin e monitorimit të aplikimeve dhe përcaktimin e personave përgjegjës të cilët nuk kanë përmbushur afatet;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të identifikuar problematikat me aplikimet e prapambetura;

- Sigurohet që përcjellja e rastit kryhet brenda 24 orësh nga ardhja në platformë;
- Sistemon e-maillet në rastet kur janë gabim dhe kontakton qytetarët në rastet kur ankesa nuk ka e-mail të saktë;
- Nëpërmjet platformës dërgon kujtesa tek institucionet, kur rasti u afrohet afateve të kthimit të përgjigjes;
- Raporton në mënyrë javore dhe sipas kërkesës tek koordinatori përgjegjës i ADB-së mbi ecurinë e rasteve që ndjek;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (*me shkrim dhe verbal*) të eprorëve.

B. Kriteret e punësimit të Specialistit janë:

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe të zotërojë të zotërojë të paktën diplomën Bachelor në Shkenca inxhinierike/ekonomike/juridike/shoqërore;
- Njohuri nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 13/2016 datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;
- Njohuri mbi Vendimin Nr. 252, datë 29.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”;
- Njohuri mbi Urdhërin nr. 87, datë 13.05.2022 “Për angazhimin e strukturave të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për të bashkëpunuar me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), për realizimin e disa detyrave lidhur me ofrimin e shërbimeve”;
- Njohuri mbi Urdhërin e Përbashkët nr. 428/1 Prot., datë 01.07.2022 “Mbi mënyrën e rregullimit të procesit të bashkëpunimit midis ADISA-s dhe ADB-së”;
- Njohuri mbi Strategjitë dhe Prioritetet e programit të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë ndikim direkt në rolin publik të Institucionit;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike;
- Të njohë një nga gjuhët e BE (avantazh përbën gjuha angleze);
- Do të ketë prioritet në vlerësimin e kandidatave personat që kanë mbi 1 (një) vit eksperiencë pune në pozicione të ngjashme/ekuivalente.

8.4 Sektori i Prokurimeve

Sektori Prokurimeve ndjek dhe zbaton të gjitha procedurat ligjore/nënligjore për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike.

8.4.1 A. Detyrat e Përgjegjësit janë:

- Drejton dhe organizon punën e sektorit të prokurimeve, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi, në fushën e prokurimeve duke hartuar planin mujor të punës, monitoron dhe raporton periodikisht te eprori i drejtpërdrejt mbi ecurinë dhe problematikat;
- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve të sektorit dhe koordinon punën drejtpërdrejt me specialistët që varen prej tij dhe informon periodikisht mbi ecurinë e sektorit;
- Bën shpërndarjen e punës në sektor, dhe merr masa për plotësimin e tyre;
- Harton dokumentet, kushtet kryesore për nisjen e procedurave të prokurimit duke bërë marrjen e ofertave, procedurat e prokurimit dhe ndjek realizimin e regjistrimit të prokurimeve vjetore;
- Asiston njësinë e prokurimit për realizimin e procedurave të prokurimit në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, nga faza e përlllogaritjes së fondit limit deri në hartimin e kontratës;
- Respekton të gjitha rregullat dhe afatet e caktuara në aktet ligjore e nën ligjore për prokurimin publik, për saktësinë dhe bazën ligjore e të gjitha akteve që dalin nga Sektori i Prokurimit duke u mbështetur në legjislacionin përkatës;
- Është përgjegjës për hartimin, dërgimin për botim, si dhe hedhjen e të gjithë të dhënave në sistemin elektronik të prokurimeve, të njoftimit të kontratës së përmbledhur, të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së nënshkruar etj., në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi, brenda afateve kohore, në Agjencinë e Prokurimit Publik, si dhe në faqen zyrtare të ëeb-it të APP-së, në rastet e pjesëmarrjes në komisionin e hartimit të dokumenteve të tenderit;
- Harton, regjistrin e parashikimeve të prokurimit publike, bazuar në kërkesat e ardhura nga sektorët, për punë, mallra dhe shërbime, si dhe i dorëzon ato në institucionet përgjegjëse, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;
- Harton regjistrin vjetor të realizimeve të prokurimeve publike si dhe i dorëzon ato në institucionet përgjegjëse, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;
- Punon periodikisht, në mënyrë të pavarur, për ngritjen profesionale dhe përditësimin me ndryshimet e legjislacionit;
- Kontrollon, analizon dhe informon mbi rezultatet e punës së punonjësve në varësi të tij;
- Vlerëson performancën e punonjësve në varësi në përputhje me procedurat e aplikueshme;
- Monitoron Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik dhe raporton dy herë në ditë, në orën 9:30 dhe në orën 16:00 tek koordinatori përgjegjës i Bashkëqeverisjes mbi mbarëvajtjen e aplikimeve, të cilat i janë caktuar sipas institucionit që monitoron, bazuar në raportin model të përcaktuar nga ADB-ja;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të përpiluar në mënyrë ditore, raportin e monitorimit të aplikimeve dhe përcaktimin e personave përgjegjës të cilët nuk kanë përmbushur afatet;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të identifikuar problematikat me aplikimet e prapambetura;

- Sigurohet që përcjellja e rastit kryhet brenda 24 orësh nga ardhja në platformë;
- Sistemon e-maillet në rastet kur janë gabim dhe kontakton qytetarët në rastet kur ankesa nuk ka e-mail të saktë;
- Nëpërmjet platformës dërgon kujtesa tek institucionet, kur rasti u afrohet afateve të kthimit të përgjigjes;
- Raporton në mënyrë javore dhe sipas kërkesës tek koordinatori përgjegjës i ADB-së mbi ecurinë e rasteve që ndjek;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (me shkrim dhe verbal) të eprorëve.

B. Kriteret e punësimit të Përgjegjësit janë:

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe të zotërojë diplomë Master Shkencor në shkenca juridike/ekonomike;
- Njohuri nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Njohuri nga Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 13/2016 datë 18.02.2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar;
- Njohuri mbi Vendimin Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- Njohuri mbi Vendimin Nr. 252, datë 29.04.2022 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre";
- Njohuri mbi Urdhërin nr. 87, datë 13.05.2022 "Për angazhimin e strukturave të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për të bashkëpunuar me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), për realizimin e disa detyrave lidhur me ofrimin e shërbimeve";
- Njohuri mbi Urdhërin e Përbashkët nr. 428/1 Prot., datë 01.07.2022 "Mbi mënyrën e rregullimit të procesit të bashkëpunimit midis ADISA-s dhe ADB-së";
- Njohuri mbi Strategjitë dhe Prioritetet e programit të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë ndikim direkt në rolin publik të Institucionit;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike;
- Të njohë një nga gjuhët e BE (avantazh përbën gjuha angleze);
- Të ketë të paktën 2 (dy) vjet eksperiencë pune në pozicione të ngjashme/ekuivalente.

8.4.2 A. Detyrat e Specialistit janë:

- Përbush të gjitha detyrat që i ngarkohen nga drejtori dhe përgjegjësi i sektorit, në zbatim të legjislacioni në fuqi. Raporton pranë përgjegjësit të sektorit në mënyrë periodike mbi përbushjen e detyrave të caktuara;
- Mban kontakte të rregullta me anëtarët e komisionit të propozuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe i vë në dijeni për datën, vendin dhe orën në të cilën do të mbledhet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave;
- Harton dokumentacionin e tenderit së bashku me komisionin përkatës (njësinë e prokurimit), për zbatimin e procedurave të prokurimit sipas kërkesave të parashikuara në ligj. Mban dhe kontrollon në çdo kohë projektet dhe preventivat që kanë të bëjnë me prokurime të infrastrukturës, ndërtimeve, shërbimeve dhe blerjeve;
- Harton dokumentacionin përkatës për procedurat e prokurimit dhe shpalljen e tyre në APP ;
- Ka për detyrë të ruajë konfidencialitetin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik në procedurat e prokurimit;
- Mban përgjegjësi për respektimin e afateve kohore të procedurave të prokurimit, njoftimin në buletin, specifikimet teknike, sigurimin e materialeve për plotësimin e dokumenteve të tenderit, përgatitjen e dokumenteve të tenderit në bazë të formularëve përkatës të parashikuar në ligj;
- Mban procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve duke pasqyruar me transparencë çdo vendim të marrë në mbledhjet përkatëse;
- Mban përgjegjësi për nënshkrimin e procesverbaleve nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave si dhe Njësisë së Prokurimit. Plotëson dosjet përkatëse të procedurave të prokurimit duke organizuar në të gjithë dokumentacionin e tenderit (*urdhër prokurimi, njoftime, vendime të komisionit etj.*);
- Bën inventarin e dosjes së procedurave të prokurimit dhe kujdeset për dorëzimin e tyre në arkivin e ADISA-s, brenda afatit të parashikuar në legjislacion;
- Përgatit regjistrin e parashikimit të prokurimeve, konform buxhetit të miratuar për investime dhe për shpenzime;
- Përditëson të dhënat në sistemin elektronik për procedurat e prokurimit dhe përgatitjen e procedurës, për KVO-në;
- Administrimin elektronik, në mënyrë periodike të procesit të prokurimit, nga shpallja e procedurës deri në arkivimin e saj;
- Ngarkon në sistemin elektronik të gjithë materialet e procedurës së prokurimit;
- Mban marrëdhënien periodike, ditore-javore me Agjencinë e Prokurimit Publik;
- Njofton në mënyrë elektronike dhe shkresore, Agjencinë e Prokurimit Publik për fazën e publikimit, njoftimit të fituesit, lidhjes kontratës dhe anulimeve përkatëse etj., sipas afateve të përcaktuara në ligj për secilën procedurë;
- Harton kontratat dhe njofton subjektin për nënshkrimin e saj;
- Asiston në mbledhjet e KVO-së dhe jep mendim, si dhe bën interpretim ligjor për Dokumentet e tenderit, atëherë kur i kërkohet nga anëtarët e KVO-së;

- Punon për rritjen dhe kualifikimin e tij profesional në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, duke synuar sjelljen e risive në punën e tyre të përditshme;
- Mban të përditësuar listën e çmimeve mbi zëra të preventivave duke bashkëpunuar me organe të specializuara (*AKSHI apo Ministria e Brendshme*);
- Përgatit çdo dokument/raport/informacion që kërkohet nga sektorët/drejtoritë e tjera;
- Monitoron Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik dhe raporton dy herë në ditë, në orën 9:30 dhe në orën 16:00 tek koordinatori përgjegjës i Bashkëqeverisjes mbi mbarëvajtjen e aplikimeve, të cilat i janë caktuar sipas institucionit që monitoron, bazuar në raportin model të përcaktuar nga ADB-ja;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të përpiluar në mënyrë ditore, raportin e monitorimit të aplikimeve dhe përcaktimin e personave përgjegjës të cilët nuk kanë përmbushur afatet;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të identifikuar problematikat me aplikimet e prapambetura;
- Sigurohet që përcjellja e rastit kryhet brenda 24 orësh nga ardhja në platformë;
- Sistemon e-maillet në rastet kur janë gabim dhe kontakton qytetarët në rastet kur ankesa nuk ka e-mail të saktë;
- Nëpërmjet platformës dërgon kujtesa tek institucionet, kur rasti u afrohet afateve të kthimit të përgjigjes;
- Raporton në mënyrë javore dhe sipas kërkesës tek koordinatori përgjegjës i ADB-së mbi ecurinë e rasteve që ndjek;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (*me shkrim dhe verbal*) të eprorëve.

B. Kriteret e punësimit të Specialistit janë:

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe të zotërojë të zotërojë të paktën diplomën Bachelor në shkenca juridike/ekonomike;
- Njohuri nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Njohuri nga Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 13/2016 datë 18.02.2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike";
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar;
- Njohuri mbi Vendimin Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";

- Njohuri mbi Vendimin Nr. 252, datë 29.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”;
- Njohuri mbi Urdhërin nr. 87, datë 13.05.2022 “Për angazhimin e strukturave të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për të bashkëpunuar me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), për realizimin e disa detyrave lidhur me ofrimin e shërbimeve”;
- Njohuri mbi Urdhërin e Përbashkët nr. 428/1 Prot., datë 01.07.2022 “Mbi mënyrën e rregullimit të procesit të bashkëpunimit midis ADISA-s dhe ADB-së”;
- Njohuri mbi Strategjitë dhe Prioritetet e programit të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë ndikim direkt në rolin publik të Institucionit;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike;
- Të njohë një nga gjuhët e BE (avantazh përbën gjuha angleze);
- Do të ketë prioritet në vlerësimin e kandidaturave personat që kanë mbi 1 (një) vit eksperiencë pune në pozicione të ngjashme/ekuivalente.

9. ZYRAT RAJONALE/VENDORE

Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), përveç drejtorisë qendrore ushtron veprimtarinë e saj dhe në Zyrat Rajonale/Vendore, në të cilat, nëpërmjet sporteleve pritëse ofron shërbime publike në sportel pavarësisht formës së organizimit të tyre (sportel i dedikuar, sportel i kolokuar, qendra të integruara etj.)

9.1 A. Detyrat funksionale të Përgjegjësit të Zyrave Rajonale/Vendore janë:

- Të koordinojë dhe të mbikqyrë punën e specialistëve të ADISA-s dhe institucioneve të administratës shtetërore të cilat ofrojnë shërbime pranë Zyrës Rajonale/Vendore;
- Të mbikqyrë mbarëvajtjen e punës dhe të organizojë specialistët në detyrat e tyre përkatëse;
- Të sigurojë bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet Zyrës Rajonale/Vendore (ADISA) dhe Zyrës Përgjegjëse për shërbimin (BO) duke mos kryer asnjë veprim/mosveprim i cili dëmton bashkëpunimin me institucionet e administratës shtetërore apo dëmton imazhin e ADISA;
- Të realizojnë me përpikmëri dhe profesionalizëm detyrat e caktuara nga eprorët, në përputhje me punën dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor kundrejt qytetarëve;
- Të zbatojnë me përpikmëri Rregulloren e Brendshme dhe çdo akt tjetër të brendshëm gjatë ushtrimit të detyrës, në marrëdhënie me qytetarët, me eprorët dhe vartësit;
- Të grumbullojë të gjitha ankesat e qytetarëve të administruara dhe dorëzuara në datën e paracaktuar dhe t’i dorëzojë pranë Njësisë Përgjegjëse të ADISA-s dhe institucionit të administratës shtetërore kur lidhen me veprimtarinë e këtij të fundit (*nëse autorizohet nga Drejtori Ekzekutiv*);
- Të monitorojë specialistët për të siguruar që proceset të kryhen në mënyrë të saktë dhe efektive si dhe të trajtojnë apo administrojnë situatat problematike të referuara nga specialistët;

- Të raportojë (raport ditor/mujor etj) pranë Njesisë Përgjegjëse për praktikën e çdo lloji të administruar;
- Monitoron Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik dhe raporton dy herë në ditë, në orën 9:30 dhe në orën 16:00 tek koordinatori përgjegjës i Bashkëqeverisjes mbi mbarëvajtjen e aplikimeve, të cilat i janë caktuar sipas institucionit që monitoron, bazuar në raportin model të përcaktuar nga ADB-ja;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të përpiluar në mënyrë ditore, raportin e monitorimit të aplikimeve dhe përcaktimin e personave përgjegjës të cilët nuk kanë përmbushur afatet;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të identifikuar problematikat me aplikimet e prapambetura;
- Sigurohet që përcjellja e rastit kryhet brenda 24 orësh nga ardhja në platformë;
- Sistemon e-mailin në rastet kur janë gabim dhe kontakton qytetarët në rastet kur ankesa nuk ka e-mail të saktë;
- Njëpërmjet platformës dërgon kujtesa tek institucionet, kur rasti u afrohet afateve të kthimit të përgjigjes;
- Raporton në mënyrë javore dhe sipas kërkesës tek koordinatori përgjegjës i ADB-së mbi ecurinë e rasteve që ndjek;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (me shkrim dhe verbal) të eprorëve.

B. Kriteret e Përgjegjësit të Zyrave Rajonale/Vendore.

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe të zotërojë diplomë Master Shkencor, përbëjnë avantazh studimet në shkenca juridike/ekonomike/shoqërore;
- Njohuri nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 13/2016 datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;
- Njohuri mbi Vendimin Nr. 252, datë 29.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”;
- Njohuri mbi Urdhërin nr. 87, datë 13.05.2022 “Për angazhimin e strukturave të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për të bashkëpunuar me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), për realizimin e disa detyrave lidhur me ofrimin e shërbimeve”;

- Njohuri mbi Urdhërin e Përbashkët nr. 428/1 Prot., datë 01.07.2022 “Mbi mënyrën e rregullimit të procesit të bashkëpunimit midis ADISA-s dhe ADB-së”;
- Njohuri mbi Strategjitë dhe Prioritetet e programit të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë ndikim direkt në rolin publik të Institucionit;
- Të ketë aftësi shumë të mira në komunikim;
- Njohuri shumë të mira kompjuterike;
- Të njohë një nga gjuhët e BE (avantazh përbën gjuha angleze);
- Të ketë të paktën 2 (dy) vjet eksperiencë pune në pozicione të ngjashme/ekuivalente.

9.2 A. Detyrat funksionale të specialistit të shërbimeve në sportele janë:

- Të kryejë trajtimin dhe administrimin e çështjeve duke ndjekur me përpikmëri hapat të përcaktuar sipas akteve ligjore/nënligjore dhe marrëveshjet e bashkëpunimit që rregullojnë shërbimin e trajtuar;
- Të dorëzojë tek Përgjegjësi i Zyrës Rajonale/Vendore informacionin mbi trajtimin e çështjeve të ngarkuara;
- Të trajtojnë kërkesat e ankesat që ata paraqesin si dhe përcjelljen tek Përgjegjësi i Zyrës Rajonale/Vendore apo Njësisë Përgjegjëse për ankesat;
- Të zbatojë rregullat e përcaktuara nga rregullorja e brendshme apo aktet ligjore/nënligjore;
- Të informojnë në mënyrë konstante eprorin direkt mbi ecurinë e punës dhe problematikat e hasura gjatë ushtrimit të detyrave që përmban pozicioni i punës;
- Të bashkëpunojnë dhe të komunikojnë me kolegët dhe me eprorët, në funksion të marrjes në kohë reale të informacioneve të dobishme në shërbim të qytetarëve;
- Të realizojnë me përpikmëri dhe profesionalizëm detyrat e caktuara nga eprorët, në përputhje me punën;
- Të zbatojnë me përpikmëri Rregulloren e Brendshme dhe çdo akt tjetër të brendshëm gjatë ushtrimit të detyrës, në marrëdhënie me qytetarët, me eprorët dhe kolegët.
- Të zbatojë marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet ADISA-s dhe institucioneve të administratës shtetërore si dhe të mos kryejë asnjë veprim i cili të dëmtojë imazhin e administratës në përgjithësi dhe ADISA-s në veçanti;
- Të identifikojnë nevojat e përgjithshme të qytetarëve/subjekteve dhe të informojë ata për çdo paqartësi në marrjen e shërbimeve publike;
- Të informojë qytetarin/subjektet për institucionin kompetent në rastin kur kërkesa e tij nuk është kompetencë e ADISA-s;
- Të japin çdo lloj informacioni që lidhet me veprimtarinë e përditshme;
- Monitoron Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik dhe raporton dy herë në ditë, në orën 9:30 dhe në orën 16:00 tek koordinatori përgjegjës i Bashkëqeverisjes mbi mbarëvajtjen e aplikimeve, të cilat i janë caktuar sipas institucionit që monitoron, bazuar në raportin model të përcaktuar nga ADB-ja;

- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të përpiluar në mënyrë ditore, raportin e monitorimit të aplikimeve dhe përcaktimin e personave përgjegjës të cilët nuk kanë përmbushur afatet;
- Bashkëpunon me koordinatorin përgjegjës të Bashkëqeverisjes për të identifikuar problematikat me aplikimet e prapambetura;
- Sigurohet që përcjellja e rastit kryhet brenda 24 orësh nga ardhja në platformë;
- Sistemon e-maillet në rastet kur janë gabim dhe kontakton qytetarët në rastet kur ankesa nuk ka e-mail të saktë;
- Nëpërmjet platformës dërgon kujtesa tek institucionet, kur rasti u afrohet afateve të kthimit të përgjigjes;
- Raporton në mënyrë javore dhe sipas kërkesës tek koordinatori përgjegjës i ADB-së mbi ecurinë e rasteve që ndjek;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (*me shkrim dhe verbal*) të eprorëve.

B. Kriteret e punësimit të specialistëve të shërbimeve në sportele.

- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe të zotërojë të paktën diplomën Bachelor, përbëjnë avantazh studimet në shkenca juridike/ekonomike/shoqërore;
- Njohuri nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 13/2016 datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;
- Njohuri mbi Vendimin Nr. 252, datë 29.04.2022 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbim-ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”;
- Njohuri mbi Urdhërin nr. 87, datë 13.05.2022 “Për angazhimin e strukturave të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për të bashkëpunuar me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), për realizimin e disa detyrave lidhur me ofrimin e shërbimeve”;
- Njohuri mbi Urdhërin e Përbashkët nr. 428/1 Prot., datë 01.07.2022 “Mbi mënyrën e rregullimit të procesit të bashkëpunimit midis ADISA-s dhe ADB-së”;
- Njohuri mbi Strategjitë dhe Prioritetet e programit të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë ndikim direkt në rolin publik të Institucionit;
- Të ketë aftësi shumë të mira në komunikim;
- Të ketë aftësi komunikuese dhe të punës në grup;

- Njohuri shumë të mira kompjuterike;
- Të njohë një nga gjuhët e BE (avantazh përbën gjuha angleze);
- Do të ketë prioritet në vlerësimin e kandidaturave personat që kanë mbi 1 (një) vit eksperiencë pune në pozicione të ngjashme/ekuivalente.

9.3 A. Detyrat e Punonjësit të Pastrimit:

- Paraqitet në punë 30 minuta para fillimit të orarit zyrtar të punës.
- Pastron dhe mirëmban nga ana higjienike sipërfaqen e zyrave, tualeteve, korridoreve dhe shkallëve të ambienteve të ADISA-s;
- Kryen pastrimin me detergjentet e duhur;
- Pastron tualetin, duke përfshirë këtu pastrimin e lavamanit, pasqyrës etj;
- Pastron pluhurat në orenditë e zyrave, si dhe lan xhamat jo me pak se një herë në javë;
- Boshatis mbeturinat si dhe pastron mbajtësen e mbeturinave;
- I përgjigjet kërkesave shtesë të punonjësve përsa i përket pastrimit;
- Mban të gjitha pajisjet e pastrimit dhe materialet në gjendje pune të sigurt dhe sanitare;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (*me shkrim dhe verbal*) të eporëve.

B. Kriteret e punësimit të Punonjësit të Pastrimit:

- Të ketë mbaruar të paktën arsimin e detyruar;
- Të ketë përvojë pune;
- Të ketë aftësi komunikuese.

9.4 A. Detyrat funksionale të Shoferit janë:

- Të sigurojë shërbimin e transportit me përgjegjësi, korrektesë dhe mirësjellje;
- Të mirëmbajë automjetin dhe të interesohet për gjendjen teknike të tij në vazhdimësi (si për ujin, vajin, alkoolin e frenave, sinjalet etj. dhe të raportojë për gjithçka tek Sektori i Shërbimeve Mbështetëse si dhe tek Drejtori i Administrimit të Brendshëm;
- Të plotësojë urdhër shërbimet për çdo lëvizje ditore dhe mujore, ku të pasqyrohet edhe kilometrazhi që ka kryer mjetei përkatës në vartësi edhe të konsumit të sasisë të karburantit. Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet në Sektorin e Financës, në Drejtorinë Ekonomike;
- Ka detyrimin të vërë në dijeni Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse për mbarëvajtjen teknike të mjeteve, për çdo avari/defekt që pëson automjeti dhe vetëm atëherë, duhet t'a dërgojë mjetein për riparim në palë kontraktore që ka fituar të drejtën për këtë shërbim;
- Të mbajë pastër dhe të bëjë kujdes për automjetet, t'i mirëmbajë ato dhe t'i pastrojë për të qenë në gatishmëri në çdo kohë;
- Të njoftojë menjëherë institucionin nëse i është vendosur gjobë për rast shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, rast për të cilin do të mbajë përgjegjësi individuale;

- Të njoftojë me shkrim dhe verbal, brenda 24 orëve, shoqërinë e sigurimit në rast aksidenti që mund të pësojnë automjetet e institucionit, si dhe duhet t'i dërgojë dokumentacionin e nevojshëm;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (me shkrim dhe verbal) të eprorëve.

B. Kriteret e punësimit për Shoferin janë:

- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- Të ketë zotësi për të vepruar;
- Të jetë i pajisur me patente të tipit B, C dhe C 1;
- Të ketë aftësi komunikuese.

9.5 A. Detyrat funksionale për Mirëmbajtësin janë:

- Merr masa për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe ambienteve të jashtme në funksion të saj;
- Për çdo parregullsi të konstatuar vepron, sipas rastit, vetë dhe njofton eprorin për veprimet e kryera;
- Kryen riparimin dhe vendosjen e bravave të dyerve dhe dritareve;
- Kryen riparimin e defekteve të pajisjeve higjieno-sanitare të banjave;
- Kryen riparimin e defekteve të ndryshme të aparateve të kondicionerëve që nuk kërkojnë shërbim të specializuar;
- Kryen riparimin e defekteve të vogla elektrike;
- Në rastet kur merren specialistë nga jashtë, ai qëndron në mbështetje të tyre, ndjek punimet, merr në fund të punimeve pjesët e vjetra që dalin nga riparimi dhe raporton te eprori përfundimin e punës;
- Kryen lëvizjen e pajisjeve (kur lind nevoja) në ambientet e institucionit;
- Raporton tek eprori për çdo defekt të konstatuar, që nuk mund të riparohet prej tij;
- Mirëmban zonat e gjelbëruara, nëse ka;
- Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër apo detyrë tjetër (*me shkrim dhe verbal*) të eprorëve.

B. Kriteret e punësimit për Mirëmbajtësin

- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- Të ketë zotësi për të vepruar;
- Të ketë aftësi komunikuese.

10. PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME

- 10.1** Drejtori Ekzekutiv i ADISA gëzon të drejtën e përcaktimit të kriterëve dhe detyrave funksionale specifike në varësi të nevojave të pozicionit të punës.

- 10.2** Në procedurën e rekrutimit të punonjësve për pozicionet vakante, i jepet prioritet promovimit të punonjësve aktual të ADISA-s nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë.
- 10.3** Promovimi nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë do të kryhet mbi bazën e arsimit, eksperiencës dhe performancës së punonjësve.